

Vota KUNDER: s'ka

Vota ABSTENIM : s'ka

Pika 2 e rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27. 05. 2024

Kryetare e këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar ose hequr në lidhje me përmbajtjen e procesverbalit i cili është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh mendimin në qoftëse procesverbalit mbahet në bazë të rregullores është në rregull pavarësisht se çfarë mund të thonë antarët e këshillit.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme. Ora 10:55, Votimi i hapur

Vota PRO: 9, Alma Kadiasi, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Mimoza Hysaj, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDER: s'ka

Vota ABSTENIM : s'ka

Pika 3 e rendit të ditës, projektvendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2024"

Kryetare e Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Fjalën e merr Znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektaktin sipas relacionit bashkëlidhur kemi vetëm një familje që ka dal nga skema.

Kryetare e Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes

Me leje fjalën e mer Z.Pëllumb Guri i cili pyet pse është penalizuar ajo familje?

Fjalën e merr Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se kjo familje është penalizuar për mos deklarim page, plus që ai është penalizuar edhe herë të tjera arsyeja është dhe në relacion.

Me leje fjalën e mer z.Pëllumb Guri i cili pyet se çfarë u bë me Beni Çuedarin?

Fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpjegon situatën , që e njeh shumë mirë zotërin edhe gjendjen ekonomike dhe shëndetësore të tij, por nuk kemi ç'farë të bëjmë në momentin që ai del jashtë shtetit sepse penalizohemi në punjoësit, por i kemi bërë aplikim të ri dhe e merr ndihmën është dhe te fondi 6%.